

32 gra janë vrarë në Shqipëri gjatë tre viteve të fundit – sipas raportit të parë për vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidin në Shqipëri për periudhën 2021-2023.

Raporti tregon se 90% e këtyre vrasjeve janë kryer nga një partner intim ose një anëtar i familjes.

Tiranë, 10 Dhjetor 2024 – Për herë të parë, Observatori Shqiptar i Femicidit, që u krijua këtë vit brenda strukturës së Avokatit të Popullit, ka publikuar një raport të detajuar mbi vrasjet e grave dhe vajzave dhe femicidin, ku rezultoi se 32 gra janë vrarë në Shqipëri gjatë periudhës 2021-2023. Afro 90% e vrasjeve (27) janë kryer nga partneri i tyre intim, ose nga një anëtar i familjes.

Raporti, i realizuar nga Avokati i Popullit me mbështetje nga UN Women dhe qeverisë suedeze, tregon se 24 nga këto raste janë identifikuar si femicide, që në dallim nga vrasjet e zakonshme, përkufizohen si vrasje të grave ose vajzave për shkak të gjinisë. Afërsisht 60% e rasteve të femicidit kanë ndodhur në banesën e viktimës.

Gjatë prezantimit të raportit, Avokatja e Popullit, znj. Erinda Ballanca, nënvizoi:

“Femicidi është kulmi i një vargu dhune dhe diskriminimi që gratë përjetojnë çdo ditë. Në Shqipëri, ky fenomen është një problem social që kërkon një reagim të fortë dhe të pandërprerë nga çdo institucion dhe individ. Ne duhet të kuptojmë se femicidi nuk është një çështje vetëm e viktimave. Ai është një problem që ka të bëjë me të gjithë ne. Çdo grua që vdes nga dhuna është një dështim i shoqërisë, i institucioneve dhe i edukatës sonë për barazinë dhe respektin reciprok. Kjo është një çështje që kërkon veprim të menjëhershëm dhe të koordinuar nga të gjithë.”

Raporti, i realizuar nga Observatori i Femicidit i ngritur në mars 2024, shërben si një mekanizëm i rëndësishëm monitorimi për parandalimin e femicidit. Përmes tij, synohet të identifikohen boshllëqet në mekanizmat e mbrojtjes për viktimat e dhunës dhe të ofrohen rekomandime konkrete për institucionet përgjegjëse. Ndër rekomandimet kryesore të këtij raporti mund të veçojmë:

- Njohja e femicidit si një vepër penale e veçantë në Kodin Penal të Shqipërisë.
- Rritja e koordinimit mes forcave të rendit, shërbimeve sociale dhe sistemit gjyqësor për të siguruar mbrojtje efektive për gratë në rrezik.

Raporti zbulon se 90% e viktimave të femicidit kanë përjetuar dhunë nga autorët e tyre më parë, duke theksuar se shenjat e hershme paralajmëruese kanë tendencën të shfaqen në forma të ndryshme të dhunës dhe abuzimit. Kjo nënvizon nevojën kritike për masa të menjëhershme dhe reagime të forta për të mbrojtur gratë dhe vajzat.

Michele Ribotta, përfaqësuesi i UN Women në Shqipëri theksoi ndikimin e femicidit si manifestimi më ekstrem i dhunës ndaj grave: “Femicidi nxitet nga diskriminimi gjinor, marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit dhe normat shoqërore të dëmshme. Ai është manifestimi më ekstrem dhe brutal i dhunës ndaj grave, i cili shfaqet në vazhdimësi të formave të shumta dhe të ndërlydhura të dhunës. Por dhuna ndaj grave dhe vajzave nuk është e pashmangshme – ajo është e parandalueshme! Observatori i Femicidit përfaqëson një mekanizëm shtesë në morinë e instrumenteve që duhet të përdorim për të eliminuar dhunën me bazë gjinore nga shtëpitë tona, shkollat, vendet e punës dhe hapësirat virtuale.”

Në vitin 2023, shkalla e femicidit në Shqipëri ishte 0.84 për 100,000 gra, më e lartë se në vitin 2022. Ndërsa kjo shkallë është më e ulët se në vendet fqinje si Mali i Zi dhe Greqia, ajo e tejkalon atë të Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë. Raporti thekson rëndësinë e mbledhjes së të dhënave të qëndrueshme dhe transparente, duke përdorur kornizën statistikore të OKB-së për matjen e femicidit.

Femicidi është një krizë globale që prek gratë dhe vajzat në çdo vend. Sipas raportit të fundit [botëror për femicidin](#), publikuar nga UN Women dhe Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin (UNODC), në vitin 2023 rreth 51,100 gra dhe vajza në mbarë botën u vranë nga partnerët e tyre intimë ose anëtarët e tjerë të familjes (duke përfshirë baballarë, nëna, xhaxhallarë dhe vëllezër). Kjo do të thotë që, mesatarisht, 140 gra ose vajza vriten çdo ditë nga dikush brenda familjes së tyre.